



Prishtinë: 27.08.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1277\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2050\_03\_20**;
- Ankesa e KESCO e datës **26.06.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 27.08.2020, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin I.G. si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_2050\_03\_20** i datës **11.03.2020**.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 03.07.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, si vendim i shkallës së parë, për këto shkaqe: konsumatori I.G. nuk ka ofruar dëshmi që shifra aktive DFE 56692 nuk i takon atij dhe nuk ka deklaruar se në cilën shifër ka shpenzuar energji elektrike deri më tani dhe se në një aneks konsumatori ka bërë kyçje të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe shpenzimi i energjisë elektrike për këtë aneks nuk është matur. KESCO në ankesë ka theksuar se konsumatori I.G. nuk e ka pranuar kyçjen ilegale, dhe ka deklaruar se me veprimtarinë e prodhimit të kriptovalutave është marrë nëna e tij 80 vjecare, që sipas tyre një gjë e tillë është e pamundur. Gjithashtu, KESCO në ankesën e tyre pretendon që ofrimi i lidhjes së re për konsumatorin I.G. do të shkaktoj një precedent të rrezikshëm të legjitimitit të keqpërdoruesve të energjisë elektrike dhe po ashtu do të ketë impakt negativ edhe në procedurën penale, përderisa nuk ka një epilog përfundimtar të zgjidhjes së këtij kontesti. Ata kanë theksuar se, nëse aprovohet një kërkesë e tillë, u ofrohet mbrojtje dhe shtytje përpërdoruesve për keqpërdorime të tilla.

KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2050\_03\_20, i datës 11.03.2020 për konsumatorin I.G..

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë, i ligjshëm dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se konsumatori I.G. nuk ka ofruar dëshmi që shifra aktive DFE 56692 nuk i takon atij dhe nuk ka deklaruar se në cilën shifër ka shpenzuar energji elektrike deri më tani dhe se në një aneks konsumatori ka bërë kyçje të paautorizuar të energjisë elektrike dhe shpenzimi i energjisë për këtë aneks nuk është matur, Bordi ka analizuar me kujdes pretendimet e tilla dhe thekson se bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se shifra DFE – 56692 është e regjistruar në emër të Sh.G., dhe se nuk i takon aplikuesit të tregoj se shifra e kujt është DFE – 56692 pasi KESCO ka të dhëna lidhur me shifrën në fjalë.

Lidhur me pretendimin e KESCO se në pikën matëse ka pasur kyçje ilegale apo shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE sqaron se bazuar në nenin 4, par. 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, konstaton se për rastet që kanë elemente të veprës penale, ZRRE nuk ka mandat ligjor për të shqyrtuar ankesën e konsumatorit. Neni 4 i Rregullës së lartpërmendur parasheh që: “Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale, vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin e XXVI të Kodit Penal – Veprat Penale kundër Shërbimeve Komunale, ku përfshihen edhe vjedhja e energjisë termike (ngrohja qendrore) janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj, këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull.

Bordi i ZRRE thekson se bazuar shkresat e lëndës konstatohet se ngarkesa me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike bërë nga KESCO në shumën prej 34,944.70 € është në emër të konsumatorit Sh.G. me shifër DFE – 56692, dhe se sipas fotove shihet se është afro 50 metra distancë me shtëpinë për të cilën është kërkuar lidhja e re.. Po ashtu, duhet theksuar se kërkesa për lidhje të re është në emër të I.G., dhe jo në emër të Sh.G., ku ekziston shifra DFE – 56692. Lidhur me ofrimin e dokumenteve kadastrale për ndarje të pronës, aplikuesi ka theksuar se është në proces e sipër të sigurimit të tyre, për faktin se prindi i tij, i ndjeri Sh.G. ka ndërruar jetë, dhe do t'i duhet kohë e mjaftueshme për përfundimin e dokumenteve. Pra, nga shkresat e lëndës Bordi e ka vërtetuar që se pika matëse ku është bërë ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar nuk është e njëjtë me pikën matëse ku është bërë kërkesa për lidhje të re nga aplikuesi. Gjithashtu duhet theksuar se bazuar në korrespondencën mes KESCO/KEDS dhe ZRRE lidhur me lëndën e konsumatorit, theksohet se KEDS në njërin anë thekson se kërkesa për lidhje të re ka të bëjë me të njëjtën pikë matëse ku është bërë ngarkesa për shfrytëzim të paautorizuar, e në anën tjetër thekson se në rast se konsumatori paraqet dokumentet kadastral për ndarje të parcelës, atëherë do të bëhet rishikimi i lëndës së konsumatorit për lidhje të re, e që ZRRE konstaton se në rastet kur është për të njëjtën pikë matëse atëherë pavarësisht dokumenteve kadastral nuk mund të hapet shifër e re, pasi ekziston shifra, e që ky argument i KESCO/KEDS nuk qëndron, dhe është argument i pabazuar.

KESCO në kundërshtimin e tyre kanë ngritur një shqetësim lidhur me ekzistimin e rrezikut për krijimin e një precedenti të legjitimitit të keqpërdoruesve të energjisë elektrike, nëse një kërkesë e tillë do të aprovohet. Bordi i ZRRE-së edhe njëherë thekson se lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike të ngarkuar nga KEDS për konsumatorin DFE – 56692, duhet të ndiqen procedurat ligjore në fuqi, pasi që siç u sqarua më lart, ZRRE nuk ka kompetencë të trajtoj lëndët me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Pra nuk mund të paraqet precedent të rrezikshëm një vendim i tillë, pasi që kemi të bëjmë me dy çështje të ndryshme, njëra ka të bëjë me kërkesën për lidhje të re, e tjetra me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE-së thekson se sipas nenit 5, par. 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Operatori i Sistemit është i obliguar të “bëjë kyçjen në rrjet të cdo aplikuesi nëse kjo kyçje është teknikisht e mundshme sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen për Kycje ..”. Pra, duke qenë se kërkesa për lidhje të re është në një objekt tjetër, afro 50 metra distancë nga objekti ku është ngarkuar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë në shifrën DFE - 56692, atëherë KEDS obligohet që t'i ofroj aplikuesit I.G.lidhjen e re, respektivisht kyçjen në rrjetin elektrik.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Boardi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I.G.dhe
- Arkivit të ZRRE-së.